

BULETINI INFORMUES

PROGRAMI I PASHTETËSISË JANAR-DHJETOR 2023


Ofrimi i ndihmës juridike falas për personat e cenueshëm të cilëve u mungon identiteti ligjor mbetet qëllimi përfundimtar i Programit për të Drejtat Civile Kosovë (CRPK). Duke mundësuar qasje të informuar në procedurat administrative dhe gjyqësore, ndryshime pozitive sillen në jetën e njerëzve ligjërisht të padukshëm.

AKTIVITETET INFORMUESE


Aktivitetet informuese të organizuara kanë qenë vendimtare për të kontaktuar **1150** individë të peregjistruar, veçanërisht ata që përballen me sfida në lidhje me regjistrimin e faktit të lindjes dhe marrjen e shtetësisë. Përmes një qasjeje proaktive, CRPK ka qenë në gjendje të identifikojë individët të cilëve u mungon dokumentacioni i duhur, duke penguar qasjen e tyre në të drejtat dhe shërbimet thelbësore.

Në mesin e individëve të kontaktuar, një numër i përgjithshëm prej **135** u identifikuan që kishin nevojë për ndihmë juridike për regjistrimin e mëvonshëm të lindjes dhe marrjen e shtetësisë.

PERSONAT E KONTAKTUAR




NË NEVOJË PËR NDIHMË JURIDIKE



NDIHMA E OFRUAR JURIDIKE

140 persona pa dokumenta përfitues të ndihmës juridike falas janë pajisur me dokumente të gjendjes civile, duke u mundësuar kështu shfrytëzimin e të drejtave dhe shërbimeve të tjera.





© 2023 CRPK

Mustafa pozon me certifikatën e lindjes

Tregimi i Mustafës

Njihuni me Mustafën, një individ, i cili, pavarësisht se u rrit pa prindër, e dinte gjithmonë se ishte ndryshe nga ata që e rrethonin për shkak të mungesës së certifikatës së lindjes dhe identitetit ligjor.

“Kam mbetur herët jetim dhe askush nuk është kujdesur të regjistroj lindjen time. Rrjedhimisht, jam i papunë dhe pa burim jetese, pasi pa dokumente personale nuk mund të lëviz lirshëm”, është shprehur Mustafa duke fshirë lotët, teksa ka kërkuar ndihmë juridike nga stafi ligjor i CRPK-së.

I vendosur për të ndryshuar situatën e tij, Mustafa filloi të shqyrtonte mundësinë e regjistrimit të lindjes së tij. I vetëdijshëm se rruga do të ishte sfiduese, ai ishte i gatshëm të bënte gjithçka që duhej për të fituar me të drejtë vendin e tij në shoqëri. Me mbështetjen dhe udhëzimin e palëkundur të stafit ligjor të CRPK-së, ka filluar procesi i mbledhjes së dokumenteve të nevojshme.

Ishte një rrugëtim pesëvjeçar i mbushur me vendosmëri, por më në fund erdhi dita kur Mustafa mori certifikatën e shumëpritur të lindjes. Në moshën 32-vjeçare, ai më në fund zotëroi një identitet zyrtar, një dëshmi e ekzistencës së tij që do të hapte dyert për një botë krejtësisht të re mundësish. Duke reflektuar mbi jetën e tij, Mustafa pranoi se rruga drejt identitetit të tij ligjor kishte qenë e vështirë, por ai definitivisht besonte se ishte një udhëtim që ia vlente të ndërmerrej. Nëpërmjet këtij procesi, ai i kishte dëshmuar shoqërisë se ishte më shumë se një fytyrë pa identitet ligjor, por një individ me ëndrra dhe aspirata, si kushdo tjetër.

Udhëtimi i Mustafës shërben si një kujtesë për kuptimin e përpjekjeve tona kolektive në promovimin e njohjes ligjore dhe mbrojtjen e të drejtave të atyre që janë në rrezik të pashtetësisë. Së bashku, ne mund të vazhdojmë të bëjmë një ndryshim në jetën e individëve, duke i ndihmuar ata të tejkalojnë pengesat dhe të përmbushin potencialin e tyre.



© 2023 CRPK

B.B gjatë aplikimit për leje qëndrim

BASHKËPUNIM I NGUSHTË ME INDIVIDËT NË NEVOJË

CRPK është e hapur ndaj kërkesave për ndihmë juridike falas nga komunitetet e cenueshme që kanë nevojë për një identitet ligjor, të cilat nuk mund t'i zgjidhin vetë për shkak të mungesës së një informacioni adekuat për procedurat, kompleksitetin e procedurave, nevojën për mbështetje ligjore dhe mungesën e disponueshmërisë së dokumentacion evidentues.

CRPK ka ofruar mbështetje për **5** individë në nevojë për vendosjen e statusit ligjor. Të gjithë ata, me vendim të Ministrisë së Punëve të Brendshme janë pajisur me letërnjoftime të përkohshme të qëndrimit që u mundëson qasje në të drejta dhe shërbime.

CRPK, si pjesë e organizatave të shoqërisë civile dhe partner ligjor i UNHCR-së, në bashkëpunim me autoritetet vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e kornizës legjislative përmes dhënies së ekspertizes ligjore për zbrazëtitrat e vërejtura në kornizën aktuale normative, si dhe ofrimin e zgjidhjeve potenciale ligjore që do të mundësojnë identifikimin dhe reduktimin e personave në rrezik të pashtetësisë.

Tri akte ligjore janë në proces rishikimi. Komentet dhe sugjerimet janë ofruar me qëllim parandalimin dhe reduktimin e pashtetësisë në përputhje me qëllimet e fushatës #Ibelong.



© 2023 CRPK

Mbajtja e sesionit të vetëdijesimit në Gjilan

Ngritja e kapaciteteve të institucioneve dhe reagimi

Kemi kënaqësinë të ndajmë një përditësim për bashkëpunimin tonë me Departamentin për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve/MPB. Përpjekjet tona të përbashkëta vazhdojnë të forcohen ndërsa punojmë drejt adresimit të sfidave të integrimit me të cilat përballen të huajt në rrugën e tyre ligjore për të krijuar identitetin e tyre. Gjatë vitit, CRPK mundësoi tre sesione vetëdijesimi në komunat e Gjakovës, Gjilanit dhe Prishtinës.

Në përputhje me Agjendën 2030 dhe SDG 16.9, diskutimet tona angazhuan përfaqësues nga institucione të ndryshme për të kuptuar më mirë çështjet thelbësore që lidhen me identitetin ligjor, të drejtat shoqëruese dhe shërbimet. Duke krijuar një mjedis të favorshëm për mbrojtjen dhe integrimin e personave me status ligjor të dhënë, ne përpiqemi të arrijmë vizionin e përbashkët të një të ardhmeje ku vlera e çdo individi njihet, si dhe një të ardhme ku secili ka një identitet.



Nëpërmjet tri ngjarjeve të rëndësishme, i bashkuam forcat me Agjencinë e Regjistrimit Civil (ARC) dhe Zyrat Komunale të Gjendjes Civile (ZKGJC) në mbarë Kosovën për të trajtuar sfidat që lidhen me regjistrimin e mëvonshëm të lindjes. Këto ngjarje për ngritjen e kapaciteteve ofruan një platformë për pjesëmarrësit që të përfshiheshin në diskutime kuptimplote rreth pengesave administrative që kontribuojnë në çështjen e lindjeve të paregjistruara. Duke eksploruar rrugët ligjore dhe duke ndarë praktikat më të mira, ne po punojmë kolektivisht për të ulur numrin e lindjeve të paregjistruara dhe për të parandaluar pashtetësinë. Këto përpjekje janë thelbësore për të garantuar se e drejta e çdo individi për identitet të njihet dhe mbrohet.

BASHKËPUNIMI ME AKADEMINË E DREJTËSISË

Në tetor, një sesion gjithëpërfshirës dy-ditor për gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët u zhvillua përmes një bashkëpunimi të ngushtë me Akademinë e Drejtësisë.

Fokusi kryesor i sesionit trajtoi çështjet që lidhen me të drejtën e identitetit dhe kompleksitetet me të cilat ballafaqohen gjyqtarët në gjykimin e lidhur ngushtë me parandalimin e pashtetësisë. Pjesëmarrësit shqyrtuan aktet legislative të ndërlidhura ngushtë me konventat ndërkombëtare së bashku me zbatimin praktik të tyre në vendimet aktuale gjyqësore.



Sesioni dyditor i mbajtur me gjyqtarë dhe bashkëpunëtor



© 2023 CRPK

Momente nga pilot iniciativa e mbajtur në Fushe Kosove, Mitrovicë dhe Gjakovë

THEKSIMI I PILOT INICIATIVËS SONË PËR IDENTIFIKIMIN E PERSONAVE TË PAREGJISTRUAR

Në përpjekjet tona të vazhdueshme për të adresuar sfidat e regjistrimit të gjendjes civile, ne kemi ndërmarrë një pilot iniciativë për identifikimin e individëve të paregjistruar në komunat Fushë Kosovë, Obiliq, Mitrovicë, Gjakovë dhe Graçanicë.

Kjo iniciativë, e organizuar në bashkëpunim të ngushtë me ZKGJC-të, Qendrat për Punë Sociale (QPS), Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK), dhe Komitetin për Komunitete, kishte për qëllim të tejkaloj hendekun ndërmjet palëve relevante të interesit dhe individëve të paregjistruar nga komunitetet e cënueshme.

Suksesi i kësaj nisme u shënua nga identifikimi i **14** personave të paregjistruar. Këto raste kanë nxitur diskutime kritike mes pjesëmarrësve, duke siguruar një qasje bashkëpunuese dhe të përkushtuar ndaj zgjidhjes së çështjeve të regjistrimit të gjendjes civile. Sinergjia ndërmjet institucioneve qeveritare, OJQ-ve dhe drejtuesve apo përfaqësuesve të komunitetit u tregua shumë e rëndësishme në lehtësimin e procesit të regjistrimit të lindjeve.

